

**Kolë Kraja (1865-1948):
Apostull i shkollës shqipe, nga Rilindja
Kombëtare deri në vitet '30 të shekullit XX**

**Kolë Kraja (1865-1948) – an apostle of the Albanian education,
from National Awakening to the 1930s.**

Abstract: *Based on archival sources, this paper explores the life and contribution of Kolë Kraja (1865-1948), a devoted teacher during the Albanian National Awakening. Kraja's steadfast dedication to the advancement and consolidation of Albanian schooling emerges as a central theme.*

Through his educational and cultural initiatives, Kraja exemplifies the essence of a quintessential representative of the Albanian National Awakening. The article offers insights into Kraja's teaching career across various Albanian cities in the late 19th-century Ottoman Empire, including Monastir, Ioannina, and Berat, where he taught Albanian to young generations, safeguarding them from assimilation while instilling concern for the Albanian question.

Furthermore, Kraja's pedagogical approach, which involved teaching diverse subjects in Albanian despite the risk of persecution by Ottoman authorities, underscores his enduring legacy and the significance of his contributions to Albanian national education history.

Additionally, the paper brings into limelight a previously overlooked aspect of Kraja's life: his service as an Albanian teacher and later as a dragoman (translator) in the royal court of Prince Wied. This period provides valuable insights into Kolë Kraja's multifaceted role in shaping Albanian cultural and intellectual spheres, culminating with him becoming head of the Brotherhood Association (Shoqnija "Vllaznia") in his hometown Shkodër in the early 1920s.

Keywords: *Kolë Kraja, Shkodër, Saverian Seminary, Dudë Karbunara, Prince Wied, Association "Vllaznia".*

Hyrje

Përgjatë epokës së Rilindjes Kombëtare Shqiptare lëvizja arsimore për zhvillimin e shkollës shqipe njohu një kthesë mjaft të madhe. Një ndër pararojet e këtij hovi të madh përparimi duke kundërshtuar kësodore politikat e Perandorisë Osmane, e cila nëpërmjet pengesave të veta u orvat

t'i mbante shqiptarët në padituri,¹ ishte qyteti i Shkodrës. Në gjysmën e dytë të shekullit XIX dhe në kapërcyell të shekullit XX, Shkodra prodhoi një brez të papërsëritshëm elitar mësuesish, të cilët përmes rropatjeve të tyre heroike u përpoqën të shkollonin të rinjtë shqiptarë në gjuhën amtare. Në këtë mënyrë ata jo vetëm luajtën rol në përhapjen e çështjes kombëtare, por edhe konsoliduan më tej traditën e fuqishme në lëmin e pedagogjisë që shkodranët e kanë manifestuar jo vetëm në atdheun e tyre përgjatë shekujve, por ama edhe në diasporë kur u detyruan të shpërnguleshin në Venedik pas pushtimit osman të Shkodrës në shekullin XV.²

Në plejadën e mësuesve shkodranë që spikatën me veprimtarinë e tyre në periudhën e Rilindjes duke kontribuar ndjeshëm në rritjen e lëvizjes së shkollës kombëtare shqipe, mund të veçojmë: Daut Boriçin, Luigj Gurakuqin, Mati Logorecin, Kolë Margjinin, Ismail Anamalin etj. Në rreshtin e këtyre intelektualëve me përmasa kombëtare, që punoi pa pushim për shkollën dhe gjuhën shqipe është edhe atdhetari shkodran Kolë Kraja.³ Ky mësues dhe veprimtar i dalluar ushtroi gjithë jetën një veprimtari të dendur në shërbim të vendit që ishte sintezë e edukatës atdhetare që mori qysh në familje dhe përgatitjes së gjerë pedagogjike, thelbësisht jezuite, me të cilën u selit në bankat e Kolegjit Saverian në Shkodër.

Karriera e tij kulturore dhe arsimore vazhdoi edhe pas Pavarësisë më 1912 dhe do të shënjohej edhe më tepër kur nisi të punonte si mësues i frëngjishtes në Gjimnazin Shtetnuer në Shkodër më 1922. Profesionalizmi pedagogjik dhe atdhedashuria e vet e zjarrtë - të cilat shkruesi i këtyre radhëve do t'i shpalosë mbështetur në dokumente arkivorë - bënë që figura e Kolë Krajës të respektohej jo vetëm nga bashkëqytetarët e tij, por edhe nga opinioni mbarëkombëtar për kontributet e dhëna ndaj Shqipërisë.

1. Vitet e hershme dhe formimi në Kolegjin e “Shën Françesk Saverit”, 1865-1883

Kolë Kraja lindi në Shkodër më 1 shtator 1865. Ai ishte djali i Jak Krajës dhe Mrije Markiçit,⁴ të cilët 7 vite më herët kishin sjellë në jetë edhe një

1 *Historia e Popullit Shqiptar II: Rilindja Kombëtare, vitet 30' të shek. XIX-1912*, (Grup autorësh), Botimet “Toena”, Tiranë, 2002, 247.

2 L. Nadin, *Shqiptarët në Venedik: Mërgim e integrim, 1479-1552*, përkthyer nga Pëllumb Xhufi, Shtëpia Botuese “55”, Tiranë, 2008, 85. Për shembull, në vitin 1501 shkodrani i mërguar Marin Beçikemi hapi një shkollë për shkencat humane në Venedik.

3 H. Bushati, *Shkodra dhe Motet*, Vëllimi I, Shtëpia Botuese “Idromeno”, Shkodër, 2005, 440.

4 Arkivi Qendror i Shtetit i Republikës së Shqipërisë (më tej *A.Q.Sh.*), Fondi (më tej *F.*) 590, Viti (më tej *V.*) 1921, Dosja (më tej *D.*) 26, fletë (më tej *fl.*) 1. Sipas dokumentit të lëshuar nga Zyra Famullitare e Shkodrës me datën 21 qershor 1921 vërtetohet se Kola i Jak Krajës është pagëzuar më 2 shtator 1865, një ditë pas ardhjes së tij në jetë.

djalë tjetër, Filipin. Ky mjedis familjar do të kishte tejet ndikim mbi Kolën qysh në moshë të njomë. Familja katolike Kraja ishte një familje qytetare shkodrane me ndjenja të thella liridashëse.⁵

Modeli pamohueshëm frymëzimi që farkëtoi qysh në vogëli atdhetarizmin e paepur të Kolës që angazhimi i vëllait të tij të madh Filip Kraja në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare (më tej L.K.Sh.). Filipi kishte një formim autodidakt dhe karakterizohej si një riosh i dhënë me mish e me shpirt pas çështjes kombëtare. Ai dallohet edhe në qershorin e vitit 1878 në ngjarjen historike të Lidhjes së Prizrenit, ku qëndron si një prej përfaqësuesëve më të denjë të Degës që pati kjo organizatë e parë mbarëshqiptare në Shkodër.⁶ Po ashtu, edhe një afërm i familjes katolike Kraja, kishte shërbyer atdhetarisht si oficer i Lidhjes së Prizrenit në Shkodër, Ndoc Palokë Kraja.⁷ Filip Kraja njihet edhe për miqësinë e tij për kokë që kishte me një adash mendjendritur shkodran, poetin rilindas Filip Shiroka. Me këtë të fundit ai lexonte dhe shpërndante fshehurazi libra edhe revista me materiale propagandistike pro-shqiptare, të cilat kundërshtoheshin nga autoritetet shtypëse osmane. Pa dyshim që materiale të tilla kanë qarkulluar në odat e famijes Kraja duke kërkshëruar vëllain e vogël të shtëpisë, Kolën, i cili afërmendshëm do të ketë pyetur vëllain e madh mbi gjendjen e tij të ankthit sa herë që i strukte sa në njërin cep të shtëpisë tek tjetri.⁸

Më 17 etor 1877 Urdhëri Katolik i Jezuitëve, që kishte depërtuar në Shqipëri qysh në pranverën e vitit 1841 përmes misionarëve jezuitë, çeli në Shkodër një kolegji që mori emrin e bashkëthemeluesit të shoqërisë Jezuite, Shën Françesk Saverit. Mandej zuri të mbiquhej Kolegji Saverian. Hapja e këtij institucioni arsimor zë fill kur një komision prej 22 vetash nga paria katolike e qytetit i shtron nevojën drejtorit të financave (një ortodoks i quajtur Çapalit) të vilajetit të Shkodrës për ngritjen e një shkolle të mesme.⁹ Ky institucion e nisi rrugëtimin e vet me një grup modest prej 30 nxënësish që shpresohej se «do të delte për dobi e nderë të gjytetit».

5 H. Bushati, *Shkodra dhe Motet*, Vëllimi I, 439.

6 S. Pepa, *Luftëtar e atdhetar i vendosur*, "Jeta e Re" XX (12.03.1986), 21, 3.

7 A.Q.Sh., F. 590, V. 1933, D. 56, fl. 1-1/1. Në këtë dosje të fondit të Nikollë Krajës ndodhet një kartolinë, që mban datën 3 mars 1933, me foton e Ndoc Palokë Krajës dhe Filip Shirokës. Dërguesi është një i afërm i Kolë Krajës nga Selaniku i cili shprehet me konsideratë për shërbimin atdhetar të Ndoc Palokë Krajës; Z. Dibra, *Fjalor Enciklopedik i Hapësirës Shkodrane: A-K*, Vëllimi I, Enti Botues "Gjergj Fishta", Lezhë, 2015, 39-40.

8 S. Pepa, *Luftëtar e atdhetar i vendosur*, 3.

9 Nj. Kazazi, *Zhvillimi i Arsimit të Mesëm në Shkodër: nga fillimet e tij deri në vitet '20 të shek. XX*, Shtëpia Botuese "Rozafa", Shkodër, 2014, 42; I. Murzaku, *Historia e Jezuitëve në Shqipëri (1841-1946): Katolicizmi, Kultura dhe Kthimi në besim*, Qendra Botuese "Shoqata e Jezuitëve", Tiranë, 2022, 64, 70. Tre misionarët e parë jezuitë që erdhën në Shqipëri, duke u vendosur në Shkodër në prill të vitit 1841 quheshin: Vincenzo Basile, Giuseppe Ignazio Guagliata dhe Salvatore Bartoli.

Mes nxënësve shkodranë që ishin pjesë e brezit të parë që studiuan në vitin përrurues mësimor të Kolegjit Saverian, 1877-1878, që edhe djaloshi 12-vjeçar Kolë Kraja.¹⁰

Në fillim, Kolegji Saverian ndoqi profilizimin e një shkolle tregtare. Kjo vinte si kërkesë e qytetarëve shkodranë për t'iu përgjigjur qoftë interesave, apo qoftë nevojave tregtare të Shkodrës, e cila sipas historianit Zija Shkodra, përgjatë shekullit XVIII «fitoi edhe randësinë e një qendre tranziti të dorës së parë për Ballkanin».¹¹ Në pamje të parë duket sikur kurrikulat lëndore që ofronte kolegji në këtë periudhë ishin të pamjaftueshme për të përgatitur një intelektual të formuar i cili do t'i shërbente mirë jo vetëm jetës ekonomiko-shoqërore të qytetit, por edhe kërkesave në rritje të L.K.Sh.-së. Ky paragjykim forcohet më tepër po të peshojmë edhe faktin se prindërit e nxënësve nuk deshën futjen e lëndës së gjuhës shqipe në kurrikulën kolegjare, porse qenë në favor të mësimi të italishtes mbështetur nga leverditë që do të sillte në marrëdhëniet ndërtregtare mes Shkodrës dhe gadishullit Apenin.¹² Duhet të kujtojmë se kapitali italian në Shqipërinë osmane të fundshekullit XIX u zgjerua me shpejtësi në sektorë të ndryshëm ekonomiko-tregtarë ku përfshiheshin transporti detar, peshkimi, bujqësia, banka etj, gjë e cila mund të vihet re kur shoqëria “Compagnia d'Antivari” (në kapërcyellin e shekullit XX) vuri nën kontrollin e vet lundrimin në liqenin e Shkodrës.¹³ Krahës kësaj, Porta e Lartë në reformat arsimore të vitit 1844 ua kishte mohuar shqiptarëve të drejtën e mësimi të gjuhës shqipe në shkollë.¹⁴

Pavarësisht këtyre kufizimeve, të cilat mund të ngjajnë si pengesa për formimin tërësor dhe bashkëkohor të një nxënësi shkodran në Shkodrën osmane të gjysmës së dytë të shekullit XIX në raport me vërsnikët e tij në botën perëndimore, Kola mori në bankat e këtij kolegji një arsimim me të vërtetë evropian dhe jezuitët e poqën atë që të çante me hapa të sigurt drejt rrugës që mjedisi familjar i kishte shestuar me shembuj referencialë atdhedashurie. Këtë pohim shkruesi i këtyre radhëve e mbështet në argumentat e mëposhtëm.

10 *Kolegja Saverjane: Nder 50 vjetët e para*, Shtypshkronja “Zoja e Papërlyeme”, Shkodër, 1928, 9.

11 Z. Shkodra, *Problemi i tregut shqiptar në shek. XVIII*, “Studime Historike” XX (1966), 3, 68-69.

12 *Kolegja Saverjane: Nder 50 vjetët e para*, 11.

13 Z. Shkodra, *Esnaft Shqiptare: shek. XV-XIX*, Shtypshkronja “Mihal Duri”, Tiranë, 1973, 327.

14 Grup autorësh, *Historia e Popullit Shqiptar II...*, 247. Kjo bëhej për arsye se osmanët i kategorizonin shqiptarët në aspektin e përkatësisë kombëtare sipas fesë, domethënë në “turq”, “grekë” dhe “latinë”, duke bërë që edhe mësimi në të katër vilajetet me shumicë shqiptare në Ballkan të zhvillohej në gjuhë të huaj.

Së pari, kur Urdhri Jezuit ngriti kolegjin në Shkodër u mbështet në përvojën evropiane¹⁵ dhe për rrjedhojë kolegji që, bazuar në vlerësimin e Faik Konicës, «por si një ansuje mesimit në mjedis të padijes që është rreth e rreth në Shqipëri»;¹⁶ së dyti, Kolegji Saverian, ashtu si institucionet e tjera arsimore që do të hapeshin më vonë në Shkodër, kishte kuadro të përgatitur nga ana kulturore, pedagogjiko-mësimore, artistike dhe profesionale;¹⁷ së treti, faktor kryesor në përgatitjen e Kolës edhe të bashkënxënësve të tjerë si qytetarë të përkushtuar ndaj komunitetit ishte edhe regjia e tyre në rrafshin moral-fetar, që përbënte një ndër qëllimet kryesore të vetë kolegjit; së katërti, ishin mjetet moderne didaktike që jezuitët sollën në Shkodër, ku këtu vlen të përmendim bibliotekën e cila në ato vite numëronte 500 tituj, pa dyshim që kjo bibliotekë i afroi nxënësit me kulturën e leximit dhe plotësonte njohuritë që merrnin gjatë orëve mësimore në lëndë të ndryshme;¹⁸ së pesti, nuk mund të lëmë pa përmendur vënien në përdorim të pedagogjisë injaciane nga etërit jezuitë, ngaqë si sistem pedagogjik është thelbësor për procesin e mësimdhënies dhe atë të nxënies, duke stimuluar tek nxënësit të menduarin kritik me qëllim përmirësimin e një përvoje sa më të përgjithshme arsimore;¹⁹ së gjashti, kinse kurrikula me të cilën u themelua Kolegji Saverian e pamundësonte mësimin e gjuhës shqipe, themeluesi i kolegjit, rektori Luigji Maza S.J., u përpoq sa mundi që t'i kushtojë rëndësi mesimit të shqipes, e cila do të kthehej në armën kryesor të veprimtarisë së mëvonshme pedagogjiko-atdhetare të Kolë

15 Nj. Kazazi *Zhvillimi i Arsimit të Mesëm në Shkodër: nga fillimet e tij deri në vitet '20 të shek. XX*, 44.

16 F. B. K. (pseudonim i Faik Konicës), *Kleri i huaj edhe Jesuitet në Shqipëri*, "Albania" IV (1900), 3, 77-78.

17 L. Shllaku, *Shkollat Klerikale: Vështrim historik nga fillimet deri më 1924*, Shtëpia Botuese "Camaj-Pipa", Shkodër, 2002, 162.

18 A.Q.Sh., F. 132, V. 1881, D. 20, fl. 47/1-48. Në këtë dosje, mes mjaft dokumentesh të ndryshme si letërkëmbime, fletëporosi famullish etj, ndodhet edhe rregullorja e kolegjit tregtar të "Shën Françesk Saverit" për vitin 1881. Në të paraqiten rregullat që duhet të ndjekin organet drejtuese, edhe kurrikula që ndjek kolegji. Në pikën e 11-të të kësaj rregulloreje shkruhet në origjinalin italisht: «Nel nostro Metodo degli studi e detto esplicitamente quanto si appartiene alla educazione morale. A questo scopo conducano specialmente due mezzi in particolare: 1. la cultura spirituale dei singoli alunni proveniente dai Padre a ciò destinato e dalla congregazione Mariana diretta secondo leregole; 2. Una biblioteca composta di libri istruttivi ameni ed utili a formare quello spirito forte e generoso che è proprio necessario in alunni...». Pra veçohen si pika themeltare për zhvillimin e nxënësve formimi moral-fetar dhenxitia e përdorimit të bibliotekës nga ana e tyre; *Kolegja Saverjane: Nder 50 vjetët e para*, 27.

19 Pa autor [botuar nga International Center for Jesuit Education], *Extract from Ignatian Pedagogy: A Practical Approach (1993)*, "International Studies in Catholic Education" V (2013), 1, 5.

Krajës;²⁰ së shtati qe larmishmëria kurrikulare e kolegjit që ishte mjaft e pasur, pavarësisht profilit të tij tregtar. Në tabelën e mëposhtme listohen lëndët që zhvilloi Kolë Kraja në vitet 1877-1883 dhe përbri tyre gjendet përmbajtja e programit mësimor të secilës syresh.

<i>Lënda</i>	<i>Përmbajtja e programit mësimor</i>
1. Italisht	Gramatikë; morfologji; lexime të shumta të autorëve italianë (sidomos të autorit Alesandro Manxoni); ushtrime në përpilimin e letrave administrative me karakter tregtar.
2. Françezisht (ose Gjermanisht)	Ortografi; u jepej rëndësi formave gramatikore të foljeve; ushtrime leximi dhe shkrimi; frazeologji letrare tregtie.
3. Histori-Dheshkronjë	Historia e lashtë greko-romake; dije mbi sistemin diellor; përshkrime të shkurtra mbi historinë e shteteve kryesore të Evropës; përshkrime historike-gjeografike të Shqipërisë; gjeografi tregtare; histori statistikash tregtare.
4. Matematikë	Gjeometri; ekuacione; njohuri mbi polinomet.
5. Shkencë natyrake	Anatomi; njohuri mbi faunën dhe florën; njohuri fizike dhe njohuri kimike.
6. Llogarim	Mësim i njësive matëse i atyre shqiptare dhe të huaja; njësime të çmimeve; përpilim kontratash për llogari; njohuri juridike mbi administratën.
7. Raviz	Vizatime me dorë të lirë dhe me mjete didaktike të formave të veçanta gjeometrike.
8. Bukurshkronjë	Mësoheshin stilet e dorëshkrimit anglez dhe gotik.
9. Besim	Trajtoheshin morali dhe praktikat e besimit të krishterë katolik.
10. Edukata Gjytetnore	Zhvillohej të dielash. Mësohej mbi vlerat e tolerancës dhe të paqes.

20 *Kolegja Saverjane: Nder 50 vjetët e para*, 11.

21 Pa autor [në vend të autorit jepet emri ose pseudonimi A.M.D.G. MQUE], *Programi i Shkollve Tregtare në Kolegj të Shë Françesk Saverit*, Shtypshkronja e “Zojës së Papërlyeme”, Shkodër, 1921, 1-14. Lëndët mësimore në këtë manual lëndor të Kolegjit Saverian të vitit 1921 janë thuajse krejtësisht identike me lëndët që jepeshin në kolegjin tekniko-tregtar saverian në Shkodër gjatë periudhës kur Kolë Kraja qe nxënës. Kjo gjë vërehet në rregulloren kurrikulare të kolegjit tregtar jezuit të vitit 1881, pika 1; Shih edhe A.Q.Sh., F. 132, V. 1881, D. 20, fl. 49. I vetmi dallim midis kurrikulës së vitit 1881 dhe asaj të vitit 1921 është se, më 1881, pos frëngjishtes mësohej edhe gjuha gjermane.

Më 25 korrik 1883 Kolë Kraja përfundon studimet pranë Kolegjit Saverian me rezultate maksimale.²² Gjithashtu, për arritjet e tij të shkëlqyera në mësimet përgjatë 6 viteve, ai nderohet nga drejtoria e kolegjit me medalje platinë dhe me një diplomë nderi.²³

Kolegji Saverian, ku Kolë Kraja kreu 6 klasë tekniko-tregtare, luajti një rol të spikatur në L.K.Sh..²⁴ Përmes objektivave pedagogjikë të etërve jezuitë mund të pohojmë pa drojë se Kolë Kraja me të dalë nga bankat e kolegjit pajiset me një kulturë të fortë në pothuajse të gjitha fushat e dijes, zhdivjelltësoi “fuqitë mendore” dhe me disiplinën e hekurt edukative jezuite ai konsolidoi kornizën e tij intelektuale që do ta vinte në shërbim të çështjes kombëtare.²⁵

2. Vitet e para tëurvejimit të rreptë osman për mësues Kolë Krajën, 1883-1900

Përparimi i një prej aspiratave më të mëdha politiko-shoqërore të programit të L.K.Sh.-së, arsimimi në gjuhë amtare i popullsisë shqiptare, zuri të përmbushje në ilegalitet të plotë nga një bërthamë e spikatur mësuesish llërëpërvësuar e patriotikë. Afërmendsh, ata përballen me një valë të gjerë arrestimesh dhe dëbimesh nga Porta e Lartë. Mirëpo, gjatë gjysmës së dytë të shekullit XIX dhe kapërcyellit të shekullit XX, qenë vetë këta mësues të cilët, në qytete të ndryshme të trevave shqiptare, çelën shkolla të fshehta shqipe nëpër shtëpi të veçanta private apo edhe dyqane. Përveç kësaj plot mësues shqiptarë, mes të cilëve do të rreshtohesh me përnderim Kolë Kraja, që punonin ndër shkollat greke, vlllehe, sllave të qyteteve kryesore të vilajeteve shqiptare²⁶, u mësuarin nxënësve nga komuniteti shqiptar «n’mendyrë indirekte» shkrimin shqip.²⁷

22 *Kolegja Saveriane: Nder 50 vjetët e para*, 7, 13, 79. Emri i Kolë Krajës veçohet edhe në librin historik kushtuar Kolegjit Saverian që u botua me rastin e 50 vjetorit të themelimit të tij. Ja çfarë thuhet në këtë libër për nxënësin Kolë Kraja: «Ende sot mahen mend provimet publike nder të gjitha landët, ba për ma se dy orë prej xasave ma të zott si ZZ. Kolë Kraja e Gjon Çuli me 25 korrik 1883...»

23 N. Haxhia, *Një vështrim i shkurtër mbi veprimtarinë atdhetare të vëllezërve Filip dhe Kolë Kraja*, në P. Perja (ed.) *Seminari i Tretë Ndërkombëtar “Shkodra në Shekuj”*: Vëllimi I, (seksioni i historisë dhe arkeologjisë), Shkodër, 2000, 151.

24 M.W.E. Peters, *Shtëpia botuese më e vjetër e Shqipërisë dhe kontributi i saj për Lëvizjen Kombëtare, arsimimin dhe kulturën: “Tipografia e Zojës së Papërlyeme” në Shkodër (1870-1945)*, Qendra Botuese Shoqata e Jezuitëve, Tiranë, 2016, 56.

25 Nj. Kazazi, *Zhvillimi i Arsimit të Mesëm në Shkodër: nga fillimet e tij deri në vitet ‘20 të shek. XX*, f. 44-45.

26 H. Myzyri, *Shkollat e Para Kombëtare Shqipe (1887-korrik 1908)*, Shtëpia Botuese “8 Nëntori”, Tiranë, 1978, 46; Grup autorësh, *Historia e Popullit Shqiptar II...*, 253.

27 G. Pistulli, *Kolë Kraja: Autobiografi*, “Phoenix” IX (2005), 1-6, 58.

Pas përfundimit të studimeve pranë jezuitëve të Shkodrës, Kolë Kraja arrin të bëjë një kurs për pedagogji në Perandorinë Austro-Hungareze.²⁸ Me shumë mundësi në Klagenfurt, aty ku dërgoheshin shumica e sapo të diplomuarëve me rezultatet të larta nga Kolegji Saverian.²⁹ Pas kthimit nga Austria, shoku i tij i shkollës Gjon Çuli, me banim në Trenovë, i gjeti një vend pune si mësues pranë gjimnazit vllëh të Manastirit. Kolë Kraja, një riosh i cili në këtë kohë e përshkruante veten si një djalosh «të thjeshtë e të devoçëm», niset drejt këtij qyteti në fillimnëntorin e vitit 1883 me kalë, i shoqëruar nga Çuli. Ai, si për të treguar edhe ndjenjat e tij të zjarrita atdhedashurore ndaj çështjes kombëtare, përgjatë rrugës nga qyteti i tij i lindjes drejt Manastirit, ku do të zinte fill karriera e tij e pasur pedagogjike, ishte veshur - sipas shënimeve të veta autobiografike - «malcorçe dhe me çakçirë».³⁰

Aty do të lidhte miqësi të ngushtë me inspektorin e shkollave vllëhe për rajonin e atyshëm, Apostol Margaritin (1832-1903). Ky i fundit ka hyrë në histori si një nga figurat më të spikatura të emancipimit arsimor të komunitetit vllëh. Përmes rropatjeve të tij të pasosura gjatë shekullit XIX u ngritën mjaft shkolla vllëhe jashtë kufijve të Rumanisë, brenda Ballkanit, ku mësimi zhvillohej në gjuhën amë.³¹ Një nga vizionet e Margaritit ishte që në shkollat e hapura vllëhe, të futeshin edhe orë të veçanta mësimore për gjuhën shqipe. Mirëpo, ky projekt i Margaritit nuk u realizua dot për shkak të kundërshtimit që hasi nga Perandoria Osmane.³²

Kolë Kraja e nisi karrierën mësimdhënëse në Manastir si mësues matematike për klasat e ulëta gjimnaziale dhe i gjuhës italiane për të gjitha klasat. Mandej pas 6 muajsh, mbasi kishte mjeshtëruar rumanishten mirë, Krajës iu besuan edhe disa orë mësimi për lëndën e historisë, po për klasat

28 H. Bushati, *Shkodra dhe Motet*, Vëllimi I, 440.

29 A.Q.Sh., F. 17, V. 1916-1937, D. 94, fl. 17. Në fondin e Atë Gjergj Fishtës, ndodhet një artikull pa autor, në dorëshkrim, ku flitet për krijimin dhe rëndësinë e Kolegjit të "Shën Françesk Saverit". Në këtë artikull tregohet se nxënësit më të shkëlqyer të Kolegjit Saverian në Shkodër dërgoheshin në kolegjin e Klagenfurtit, i njohur për traditën pedagogjike në formimin e mësuesëve.

30 A.Q.Sh., F. 590, Pa vit, D. 1, fl. 1. Dokumenti i cituar është një material me të dhëna autobiografike shkruar nga vetë Kolë Kraja ku tregon me vite qytetet ku ka shërbyer si mësues, qysh prej 1883-shit, kur diplomohet, e gjer më 1903 kur rikthehet në Shkodër.

31 G. Motta, *The Fight for Balkan Latinity. The Aromanians until World War I*, "Mediterranean Journal of Social Science" II (2011), 3, 254.

32 G. Pistulli, *Kolë Kraja: Autobiografi*, 57. Projekti në fjalë i Margaritit kishte si synim të forconte më tej marrëdhëniet e miqësisë midis vllëhëve edhe shqiptarëve që ndodheshin në Maqedoni e më gjerë, edhe së dyti për ta përdorur si kundërpeshim ndaj depërtimit të propagandës shoviniste të fqinjëve sllavo-grekë.

e para.³³ Gjithmonë shquhet për rregullin edhe disiplinën e fortë që vinte në klasë.³⁴

Në këtë periudhë krahas rumanishtes, ai përvetësoi më tej edhe gjuhën frënge nga prifti lazarisht, Atë Zhan Klod Faverial (1817-1893), i cili atëbotë po përgatiste një libër mbi historinë e Shqipërisë.³⁵

Qëndrimi në Manastir pati një ndikim të pashlyeshëm për Kolë Krajen si mësues dhe mbi të gjitha si individ në shërbim të çështjes kombëtare. Mësimdhënia që ushtroi aty e bëri atë një kuadër më të përgatitur në rrafshin profesionalo-pedagogjik. Në dimensionin patriotik, gjimnazi vllleh në Manastir e shndërroi atë në një “atdhetar të flaktë”, pse aty ai jo vetëm orvatet të ngrejë lidhje me adhetarë të tjerë shqiptarë, por edhe rreket të propagandojë idetë kryesore të L.K.Sh.-së tek shqiptarët e Maqedonisë. Kjo veprimtari e tija ra në sytë e organeve policore osmane të cilat, pasi i bënë një kontroll në vendbanimin ku qëndronte, i gjetën libra në gjuhën shqipe.³⁶

Në një tjetër rast, që përkon me vitin 1888, teksa po kthehej nga Shkodra në Manastir, policia osmane i bën një këqyrje në Durrës dhe i gjen ndër xhepa 5 kopje të poemës vashërore “Ervehaja” shkruar nga Muhamet Çami. Mandej ai arrestohet dhe munda të dilte prej burgut vetëm falë ndërhyrjes së një miku nga Ternova e Manastirit.³⁷

Kjo ngjarje mjaftoi që Kolë Kraja të pushohet nga puna. Pas orvatjesh të pamata, inspektori i shkollave vlllehe Apostol Margariti, e cakton si mësues në gjimnazin vllleh të Janinës ku edhe këtu jep lëndët e matematikës edhe të gjuhës italiane.³⁸ Më vonë më 1890, Kolë Kraja do të emërohej mësues në Gjirokastër, ku do të jepte krahas matematikës edhe fizikë.³⁹ Në qytetin e ngurtë ai bie në kontakt me patriotët gjirokastritë, të cilët e ndihmojnë atë të vijojë veprimtarinë e tij këmbëngulëse atdhetare.⁴⁰

Përsëri rrjeti survejues policor osman i vihet këmba-këmbës Kolë Krajes, këtë radhë si përhapës i gazetës shqipe “Drita” të kolonisë shqiptare

33 A.Q.Sh., F. 590, Pa vit, D. 1, fl. 1.

34 G. Pistulli, *Kolë Kraja: Autobiografi*, 57.

35 R. Elsie, *A Biographical Dictionary of Albanian History*, I.B. Tauris & Co. Ltd, New York, 2013, 138-139. Atë Faveriali me Kolën Krajen ishin pjesë e të njëjtit staf pedagogjik. Në gjimnazin vllleh të Manastirit, meshtari lazarisht jepte frëngjisht dhe mësimë filozofie. Vepra e këtij të fundit mbi historinë e Shqipërisë botohet në vitin 2001 nga Robert Elsie nën titullin “*Historie de l’Albanie*”.

36 N. Haxhia, *Një vështrim i shkurtër mbi veprimtarinë atdhetare të vëllezërve Filip dhe Kolë Kraja*, 149.

37 G. Pistulli, *Kolë Kraja: Autobiografi*, 58.

38 *Ivi*.

39 A.Q.Sh., F. 590, Pa vit, D. 1, fl. 1.

40 S. Pepa, *Punoj për shkollën dhe gjuhën shqipe*, “Jeta e Re” XV (03.10.1986), 79, 3.

në Bukuresht. Kjo e futi mjaft herë në telashe me gjykatoret e qytetit të ngurtë.⁴¹

Nga dëshmitë e tij njoftohet se shërbeu edhe si mësues në Tepelenë në vitet 1888-1890.⁴²

Më 1890, Margariti e lëviz sërishmi dhe kësaj radhe në Berat, ku karriera klandestine e Kolë Krajës si mësues në shërbim të përhapjes së gjuhës shqipe do të shënjojte kulmin.

Në qytetin e Beratit ai themelon të parën shkollë vllehe, e cila grupohej në klasat e djemve dhe të vajzave. Është interesante të përmendim këtu se mësuesja kujdestare për klasat e vajzave ishte Anastasia Kristoforidhi, e bija e gjuhëtarit mendjendritur rilindas, Konstandin Kristoforidhi. Veprimtaria e tij në shërbim të arsimit dhe shkollës ilegale shqipe e vuri në kontakt edhe me personalitete apo dyer të mëdha beratase. Për shembull, Kolë Kraja zuri të bashkëpunonte me Babë Dudë Karbunarën.⁴³ Në qytetin e 1 000 dritarëve, mësuesi shkodran vuri lidhje të ngushta edhe me shtëpinë aristokrate të Vrionësve.⁴⁴ Ai qe mësuesi i parë i shqipes edhe i frëngjishtes për dy djemtë e Aziz Pashë Vrionit, Hysen bej edhe Iljaz bej Vrionit. Aziz Pasha ndër ato vite shërbente si deputet në Asamblenë e Përgjithshme të Perandorisë Osmane.⁴⁵ Vrionësit gëzonin respekt të pakufijshëm për Kolë Krajën, i cili qe «propagandist i flaktë i ndesisë kombtare».⁴⁶

Nuk ka asnjë dokument më të plotë që provon veprimtarinë atdhetare të “zotni” Kolë Krajës në Berat sesa një letër-dëshmi e patriotit të shquar beratas Islam Vrioni. Ky i fundit e cilëson Krajën si «apostull të idhesë kombëtare». Diku tjetër vëren se: «Punoi për çështjen kombëtare pa marrë parasysh as rrezikun me bjerrë nëpunësin qi kishte, as ndjekjet e autoriteteve turq...»⁴⁷

41 A.Q.Sh., F. 590, V. 1929, D. 2, fl. 1-2. Ky dokument i datës 25 shkurt 1929, përmban një dëshmi me të dhëna biografike për Kolë Krajën dhe përvëllain e tij, Filipin, ku përshkruhet shkurtimisht veprimtaria patriotike e të parit. Nënshkruesit e kësaj dëshmie, qytetarë shkodranë, që në krye të letrës e cilësojnë Kolë Krajën si «propagandist të flaktë të ndjesisë kombëtare e si luftar shovenist kundra pershndetjes në gjuhë të huej».

42 A.Q.Sh., F. 590, Pa vit, D. 1, fl. 1.

43 G. Pistulli, *Kolë Kraja: Autobiografi*, 58.

44 E. Vlora, *Kujtime: 1885-1925*, përkthyer nga Afrim Koçi, Botimet “IDK”, Tiranë, 2001, 612.

45 A.Q.Sh., F. 590, V. 1929, D. 57, fl. 5. Letër që Hysni bej Vrioni i dërgon Kolë Krajës më 9 mars 1929, ku evidentohet se ai dhe i vëllai kanë qenë nxënës të tij.

46 *Ibid.*, fl. 4. Dëshmi e Hysni bej Vrionit në favor të Kolë Krajës.

47 A.Q.Sh., F. 590, V. 1929, D. 2, fl. 3. Vetë titulli i artikullit është frymëzuar nga njëra prej dëshmive të mësuesit beratas Islam Vrioni për Kolë Krajën, i cili e cilëson atë si «apostull të idhesë kombëtare». Pohimi i Vrionit pasqyron përfshirjen solide të Krajës në L.K.Sh.. Autori ka ruajtur në titull termin “apostull” për të theksuar përkushtimin e paepur dhe vetëmohimin e rrallë të Kolë Krajës si mësues i gjuhës shqipes për të rinjtë shqiptarë.

Tashmë si drejtor i një institucioni arsimor, pozicion më se i merituar meqë ishte vetë themeluesi i tij, ai pati më tepër liri veprimi si të ushtronte tërthorazi pedagogjinë e tij për mësimin e gjuhës amtare. Pasi u shpjegonte nxënësve shqiptarë mësimin në gjuhën vllehe i porosiste që në shtëpi t'i përkthenin në shqip mësimet e marra në klasë.⁴⁸

Qeverisja osmane vendosi të merrte masa për këtë dhe për tre muaj me radhë komisari policor në Berat, Aziz Efendi Qorri, i bëri kontrolle thuajse të përditshme shtëpisë ku banonte Kolë Kraja.⁴⁹ Porse, gjatë qëndrimit në Berat, Kraja u përpoq të kundërshtonte edhe ndikimin e propagandës greke.⁵⁰

Pas 2 vitesh si drejtor dhe mësues në shkollën vllehe të Beratit, ai transferohet përsëri. Këtë herë në Durrës për të themeluar aty një shkollë sipas atij modeli të suksesshëm në Berat. Por, problemet e qëllimshme burokratike e bënë të pamundur këtë plan, pavarësisht rropatjeve të stërmundimshme që bëri.

Viti 1893 e gjeti mësues Kolën sërish në gjimnazin vllëh të Janinës, si mësues të matematikës dhe italishtes. Ai do të qëndronte aty për 7 vite të tjera, të cilat nuk kaluan aq qetë sa më përpara. Qysh në vitin e parë të rikthimit të tij ngjau një skandal jo i vogël brenda gjimnazit. Drejtori i ri i shkollës së mesme u përpoq të vendoste kontroll arbitrar mbi metodat e mësimdhënies, duke minuar veprimtarinë kombëtare që ushtronin tinëz mësuesit shqiptarë. Kjo përpjekje hasi rezistencën e mjaft mësuesve. Në një rast dy roje të armatosura, dy shqiptarë delvinjotë, penguan hyrjen e Krajës në gjimnaz dhe madje e kërcënuan me dyfek. Kraja u kundërpërgjigj duke e denoncuar si ngjarje pranë Esat Pashë Toptanit, shefit të xhandarmërisë në Janinë, i cili vuri në dijeni me vrik valiun. Çështja u mbyll me shkarkimin e drejtorit problematik.⁵¹

Të tëra këto orvatje sfiduese të mësimdhënësve shqiptarë në këtë fazë të Rilindjes Kombëtare qoftë me mësimin e shqipes në mënyrë të fshehtë, qoftë me shpërndarjen e teksteve me përmbajtje atdhetare ishte, sipas fjalëve të rilindasit të madh Luigj Gurakuqi, «pune propagande, ce nuke behet per fitim, po per te mire t'gjuhes e t'konbit shcipetar!».⁵²

Ky rol i tij përbënte një prej pikave më kryesore ideologjike të çështjes kombëtare – ngjashëm me një apostull që shihet si mbrojtës edhe lajmëtar i pathyeshëm i një ideali të epërm.

48 Haxhia, *Një vështrim i shkurtë mbi veprimtarinë atdhetare të vëllezërve Filip dhe Kolë Kraja*, 149.

49 A.Q.Sh., F. 590, V. 1929, D. 2, fl. 3.

50 G. Pistulli, *Kolë Kraja: Autobiografi*, 59. Propaganda e politikës shoviniste përcillej nga mësuesit grekë, të cilët mbështeteshin nga zëvendëskonsulli i Greqisë në Berat, Perikli Stavro, një prej kundërshtarëve më të vendosur të Kolë Krajës.

51 *Ibid.*, 59-60.

52 A.Q.Sh., F. 2, Pa vit, D. 74/1, fl. 262. Pjesë nga një letër që Luigj Gurakuqi i dërgon Asdrenit më 7 dhjetor 1906.

Të dashur shokë,

Së pari, ju uroj shëndet e gjatë të mirë të punë, famije dhe kudo.
Më quajnë Simon Pepe, jam pedagog në institutin e Lartë Pedagogjike të Shkodrës, në katedrën e gjuhën shqipe.-
Duke gjurmuar rreth disa ligurve patriotike të enqur në Shkodër, rastësisht tani së fundi më re në dorë një letër e pa njohur e patriotit dhe ioklorastit të enqur, Sotir Kolea, dërguar muresit të tij të nderuar Kolë Kraja.

Duke pasur parasysh që Sotir Kolea pjesën më të madhe të jetës së tij e ka kaluar në Elbasan, (vendi ndjen mua ja di mirë), mendova t'i dërgoj gazetës suaj këtë artikull të shkurtë. Së bashku me të po ju dërgoj dhe një kopje të të letres së permendur më lart. Po e pëto të arsyeshme ju lutem botojte, me qene se është dhe 40-vje-tori i vdekjes së këtij patrioti të shquar.-

Se u takon vëllezërve dhe Kole Kraja, për të cilin bëhet ijsie në letër, sidomos për Kolea, dhe këto janë ligura të nderuar këtu në qytetin tonë dhe rang kombetare, pra mund të cilosen pa merak.-

Për këto mendje është shkruar disa herë dhe në shtypin lokal dhe kombetare. Kështu në gazetën tonë jeta e re, kemi të botuar këto artikuj:

1) Punë për shkollën dhe gjuhën shqipe kushuar mësuesit të pa lodhur kole Kraja shkruar nga Simon Pepe botuar me tre tetor 1981.-

2) Shtëpia e djalendyanës kushuar poetit t'p Shiroka dhe shtëpisë së tij të lindjes. Në një vend të caktuar në këtë artikull bëhet ijsie dhe për veprimtarinë patriotike të vëllezërve Kraja, të cilët jetuan në shtëpinë e Filip Shirokës, pas largimit të tij. Artikulli është shkruar nga Mikel prqoushi botuar po në jetën e re me 9. Nëntor 1985.-

3) Në albumin me temë: "Gjurmë të Historisë kombetare në rrotullin e shkollës". Tiranë, 1982 përgatitur nga Këshilli i Udhës, në një vend të caktuar është përqitur dhe ligura e patriotit Filip Kraja.-

4) Në revistën "VLLI" nr. 2 1970, në artikullin me artikullin plak i lurtës i shqipes, jepet dhe një letër e patriotit Bab Dud Karumara dërguar kryetarit të shqetës shqiptarëve të bularehitit, Nikolla Rago, ku, në mes të tjerëve bëhet fjalë dhe për veprimtarinë të tasesit Kolë Kraja në qytetin e Beratit ku shërbej disa vite.

Për të dy vëllezërit patriot është folur durr herë dhe në shtypin lokal. Pra sig shihet janë ligura të nderuar.

Se i takon Sotir Kolea, për të është shkruar njëjtë, ju mund të shifni vetëm studiun e fundit të Doc. Vangjel Beksit, me titull: "Gjurmë i pasit uer i vëllezërve shqiptarëve të popullit" botuar në gazetën ditë me 21-12-1980 faqe 11.-

Në qoftë se e shifni të arsyeshme botimin e këtij artikulli më do të ishte të shqetësoj me një fotografi të patriotit Sotir Kolea.-

Mirë do të ishte që ky artikull të botohesh mërendis këtij viti me qe është dhe 40-vjetori i vdekjes së tij. Në fakt se unë po ju dërgoj me vonesë, por tani kam rënë në gjurmët e kësajje letre.

Po u botue artikulli ju lutemi pa dergoni një kopje.

Më falni për shqetësimin.-

Shum të fola

(Simon Pepe)

P.S.-

Në qoftë se nuk e shifni të arsyeshme botimin ju lutemi të më ktheji një rreth përgjigjeje, që të kerkohet përgjigje.-

Letër e prof. Simon Pepës drejtuar redaksisë së një gazete (nuk jepet emri), Shkodër, 03.12.1985, marrë nga: A.Q.Sh., F. 590, Pa vit, D. 17, fl. 26-27.

3. Veprimtaria e dendur atdhetare e Kolë Krajës në Shkodër dhe shpallja e Pavarësisë, 1901-1912

Me ardhjen në shekullin e ri Kraja do të vendohet në Gjirokastrë, por jo më si mësues. Në vitet e para të 1900-s, Kraja nis të punojë brenda fushës së tij të vërtetë profesionale, pra në tregti. Gjithçka filloi me një bisedë që ai pati me konsullin e Italisë Xhorxho Milelire, të cilit i kërkoi një vend pune, që të mos trazonte veprimtarinë e tij atdhetare. Konsulli Milelire i propozoi një vend pune në Gjirokastrë, ku do të shërbente si agjent për të përhapur tregtinë italiane në jug të vendit. Paralelisht me këtë aktivitet Kolë Kraja edhe këtu gjeti hapësirën për t'u marrë me punët e L.K.Sh.-së.⁵³ Në Gjirokastrë zuri të qarkullonte ilegalisht revistën "Drita".⁵⁴

Pas dy vjetësh vendoset në Shkodër, ku do të punojë së bashku me të vëllain, Filipin, në shoqërinë italiane "Puglia". Nën maskën e nëpunësve tregtarë të një firme evropiane, ata mundën të kishin kontakte me botën jashtë vilajetit të Shkodrës. Vëllezërit arritën të fusnin në vend klandestinisht mjaft revista të huaja kulturoro-patriotike që shqiptarë të zëshëm botonin kudo.⁵⁵ Po në këtë periudhë vlen të përmendet bashkëpunimi që nisi me Filip Shirokën, kurse më herët mësues Kraja kishte bashkëpunuar edhe me veprimtarin e madh shkodran të Rilindjes Kombëtare, Pashko Vasën. Bashkazi, ata rreken fort për të sendërtuar zgjimin e ndërgjegjes kombëtare.⁵⁶

Afërmendsh kjo ishte një veprimtari që u pikas nga autoritetet osmane - sikundër radhët e kalura. Mirëpo, vitet shtypëse dhe tëurvejimit të rreptë osman - ku Filip Kraja edhe arrestohet - për dy vëllezërit Kraja do të sosnin me ardhjen e xhonturqve (Turqve të Rinj) më 1908.⁵⁷

Revolucioni Xhonturk, që i parapriu shpalljes së kushtetutës në Perandorinë Osmane në etapat e para të tij, përbente zhvillim qoftë në përfaqësimin e shqiptarëve në parlamentin e ri osman, qoftë në forcimin e lëvizjes kulturoro-arsimore në vend. Mirëpo, nuk kaloi shumë kohë dhe xhonturqve u del në pah politika e tyre reale që ishte shkombëtarizimi i kombeve nën sundimin e Portës së Lartë me qëllim turqizimin e tyre. Megjithëkëtë, veprimtaria e ndezur kombëtare në Shqipëri, i shtrëngoi xhonturqit të bënin lëshime.⁵⁸

Në këtë vit, gjithashtu, zë vend edhe ngjarja më e qenësishme politike

53 *Ibid.*, 61.

54 S. Pepa, *Punoi për shkollën dhe gjuhën shqipe*, 3.

55 G. Pistulli, *Kolë Kraja: Autobiografi*, 61.

56 A.Q.Sh., F. 590, Pa vit, D. 17, fl. 17.

57 S. Pepa, *Luftëtar e atdhetar i vendosur*, 3.

58 E. Jacques, *Shqiptarët: Historia e popullit shqiptar*, përkthyer nga Edi Seferi, Vëllimi I, Yeni Yasam Yayinlari Ltd, Stamboll, 1995, 385-386.

e kulturore për kombin shqiptar në historinë e tij moderne. Në qytetin e Manastirit, në nëntor të 1908-s, mbahet kongresi për zgjidhjen e njësimi të alfabetit në gjuhën shqipe. Siç dihet gjerësisht, komisioni i hartimit të alfabetit në Kongresin e Manastirit zgjodhi një alfabet për shqipen të bazuar sipas sistemit të alfabetit me gërma latine të shoqërisë shkodrane “Bashkimi”.⁵⁹ Më vonë edhe babai i shtetit shqiptar, Ismaili Qemali (asokohe deputet i Vlorës në parlamentin osman) do ta përshëndeste një ngjarje të tillë kaq të rëndësishme. Ky i fundit më vonë do të falënderohej nga parijska e komunitetit katolik të Shkodrës, kryesuar prej Kolë Krajës, për mbështetjen që kishte treguar kundrejt alfabetit shqip me gërma latine të miratuar në Kongresin e Manastirit.⁶⁰

Më 1911, qeveria osmane autorizon valiun e Shkodrës t’u japë leje disa të rinjve shkodranë për të hapur një klub letrar-kulturor.⁶¹ Faktikisht ky klub qe dega në Shkodër e klubit anonim të Stambollit që drejtohej prej publicistit atdhetar Dervish Hima.⁶² Klubi u quajt “*Gjuha Shqype*” dhe themeluesit kryesorë të saj qenë vetë Kolë Kraja dhe fotografi i shquar rilindas Kel Marubi. Ky organizim i ri në jetën kulturore dhe arsimore të Shkodrës e të Shqipërisë, që si kryetar të saj pati mësuesin e sprovuar Kraja, botoi mjaft libra shkollorë edhe gjuhësorë.⁶³ Një nga veprat më cilësore nga ana didaktike që nxorri klubi “*Gjuha Shqype*” fill sa u krijua ishte libri i vogël “*Knime t’para për t’rritshëm*”. Ky libër, gjykuar sot, jo vetëm ngjan tepër modern për kohën, porse nisur nga kriteret pedagogjiko-didaktike të vetë librit është thuajse bashkëkohor edhe në përmbajtje me normat e hartimit të teksteve aktuale të ciklit të ulët të shkollave të sotme 9-vjeçare në Shqipëri.⁶⁴

59 T. Osmani, *Udhë e Shkronjave: Histori e Alfabetit*, Shtypshkronja “Ilar”, Tiranë, 2008, 506, 511, 542.

60 A.Q.Sh., F. 20, V. 1910, D. 5, fl. 1. Përmes një telegrami që mban datën 21 shkurt 1910, komuniteti katolik i Shkodrës falënderon Ismail Qemalin, me motivacionin “për burrëri që dëftuat duke mprojtur shkronjat shqipe sikundër i kaa përlqyer Kongresi i Manastirit...”.

61 N. Haxhia, *Një vështrim i shkurtë mbi veprimtarinë atdhetare të vëllezërve Filip dhe Kolë Kraja*, 149.

62 A.Q.Sh., F. 590, Pa Vit, D. 17, fl. 18. Në këtë dosje ndodhen të grumbulluara materiale të ndryshme si artikuj apo kujtime të personaliteteve të ndryshme mbi Kolë Krajën.

63 Arkivi i Muzeut Historik Shkodër (A.M.H.Sh.), Fondi: Arkivi i Vjenës, 1908-1911, fl. 502-503. Në raportin e datës 20 shkurt 1911 që konsulli austro-hungarez në Shkodër i dërgon Ministrisë së Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë njoftohet se Kolë Kraja është kryetar i kësaj shoqërie të sapothemeluar në Shkodër.

64 Pa autor [botuar nga Klubi “Gjuha Shqype”], *Knime t’para për t’rritshëm*, Shtypshkronja “Nikaj”, Shkodër, 1911, 3-35. Ky titull përbënte një literaturë tejet cilësore për fëmijët e klasave të para. Libri mbulon një gamë të gjerë temash duke përfshirë kaligrafinë, gjeografinë, historinë, zoologjinë, mësoheshin këngë dhe poezi. Mbi të gjitha, përfshin elemente të edukimit atdhetar. Autori hedh mendimin se edhe po ta krahasojmë me

Ndër të tjera, klubi “*Gjuha Shqype*” në janarin e vitit 1912, bën orvatje edhe për ngritjen e një biblioteke modeste publike në Shkodër.⁶⁵

Në prag të shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, kur Shkodra ishte e rrethuar nga trupat serbo-malazeze, valiu dhe njëherësh komandanti i forcave ushtarake të vilajetit të Shkodrës, Hasan Riza Pasha, mbledhi parinë e qytetit. Një nga anëtarët e parisë, Kolë Kraja, u shpreh energjikisht se mbarë pariya ishte në favor të vetëqeverisjes së vendit.⁶⁶

Aspirata shumëshekullore e shqiptarëve për pavarësi, për të cilën Kolë Kraja kishte luftuar me shpirt, duke u shtypur edhe nga autoritetet përndjekëse osmane, finalizohet më 28 nëntor 1912. Por Shkodra do ta festonte pavarësinë e plotë më 14 maj 1913, kur trupat malazeze u larguan nga qyteti, për t’i lënë vendin administratës ushtarake të forcave ndërkombëtare.⁶⁷

4. “Dragomani mbretnuer”, 1913-1920

Qysh në muajt e parë të krijimit të Shqipërisë së pavarur, gjendja në vend u karakterizua nga një paqëndrueshmëri e thellë. Një ndër faktorët që kontribuoi më së tepërmi në këtë kohë ishte lëvizja separatiste e Esad Pashë Toptanit. Lëvizja esadiste me efekt të madh përçarës në përpjekjet për konsolidimin e shtetit shqiptar zënë fill që me dorëzimin e Shkodrës në duart e Malit të Zi dhe arrin kulmin me themelimin e një qeverie paralele me atë të Vlorës. Në Durrës më 12 tetor 1913, krijohet Pleqësia e Shqipërisë së Mesme,⁶⁸ e cila u mor me përgatitjet e mbërritjes së monarkut të ardhshëm të Shqipërisë, princ Vilhelm cu Vidit nga Gjermania.⁶⁹

Në këto përgatitje do të luante rol edhe Kolë Kraja, në një mënyrë tejet interesante.

Do të ishte Esat Pashë Toptani i cili më 1 dhjetor, me propozim të Filip Nogës, do të thirrte në Durrës Kolë Krajën për t’i kërkuar nëse dëshironte

librat e tjerë të singjashëm didaktikë në bibliografinë shqipe të botimeve të kohës, pra nga kapërcyelli i viteve 1900 deri me shpalljen e Pavarësisë, kjo vepër spikat fort për përmbajtjen multidisiplinare dhe shteruese në gjithë fushat që cek. Gjithashtu, sasia e informacionit në këtë libër i përshtatet moshës së nxënësve të klasave të para.

65 A.Q.Sh., F. 580, V. 1912, D. 29, fl. 1. Parija e klubit “Gjuha Shqype”, përmes një njoftimi që mban datën 15 janar 1912, bën me dije anëtarët dhe mbështetësit e saj për nismën e hapjes së “një biblitokë t’dobishme për msim t’popullit”.

66 A.Q.Sh., F. 590, Pa Vit, D. 17, fl. 1. E dhëna e sipërcituar është marrë nga një artikull i shkurtër biografik dorëshkrimor për Kolë Krajën nga Gjon Kamsi.

67 R. Gurakuqi, *Shqipëria: 1911-1914*, UET Press, Tiranë, 2012, 521.

68 Grup Autorësh, *Historia e Popullit Shqiptar III: Periudha e Pavarësisë 28 Nëntor 1912-7 Prill 1939*, Botimet “Toena”, Tiranë, 2007, 46-47, 49.

69 *Ibid.*, 57.

të ishte tutori që do t'i mësonte shqip princ Vedit dhe bashkëshortes së tij.⁷⁰ Kjo vinte nga reputacioni i mirë që gëzonte Kolë Kraja si një mësime të kalibrit dhe poliglot me njohje të thellë në disa gjuhë. Në moshën 48-vjeçare fliste 7 gjuhë të huaja si: rumanisht, greqisht, turqisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht dhe mund të ketë pasur dije jo të cekëta mbi latinishten.⁷¹ Ai iu përgjigj pozitivisht dhe pa humbur kohë nisete për Berlin me datën 5 dhjetor.⁷²

Me të mbërritur në Berlin, Kola i shkruan së shoqes se sa i mahnitur kishte mbetur nga madhështia qytetërore e periudhës vilhelmine të Rajhut perandorak.⁷³

Kraja do t'i jepte mësim në gjuhën shqipe princ Vedit dhe së shoqes së tij Sofisë për pothuajse tre muaj, nga ku mund të hamendësojmë se monarku gjermano-shqiptar mund ta ketë zotëruar shqipen në një nivel të kënaqshëm. Vlen të përmendet se qysh në ditët e para ai ndërtoi raporte të përzemërta me familjen princërore gjermane,⁷⁴ që do të ngriheshin në rangun mbretëror porsa të vinin këmbë në Shqipëri. Ja pse mësuesi nga Shkodra mori si dhuratë më 1913 nga princ Vidi një album fotografik të familjes aristokratike Nojvid.⁷⁵

Ardhja e “mbretit” të ri ndodhi në mars të vitit 1914, ndonëse vendimi për të qenë monark i mbretërisë shqiptare qe marrë në nëntor të vitit 1913 nga Fuqitë e Mëdha evropiane.⁷⁶ Sakaq një ndër vendimet e para të kabinetit

70 G. Pistulli, *Kolë Kraja: Autobiografi*, 62. Filip Noga më vonë do të shërbente si ministër financash në qeverinë e princ Vedit.

71 A.Q.Sh., F. 590, Pa Vit, D. 17, fl. 9. Sipas një materiali jetëshkrimor mbi Kolë Krajën. Autorësia nuk jepet, por, bazuar në ngjashmëritë në stil që ka ky material me artikullin për Kolë Krajën të gazeta “Jeta e Re” me autor pedagogun në Institutin e Lartë Pedagogjik në Shkodër, Simon Pepa, ka shumë mundësi që të jetë hartuar nga ai; shih fletën 26; A.Q.Sh., F. 132, V. 1881, D. 20, fl. 49. Mbështetur në pikën 1 të rregullores së posaçme kurrikulare të Kolegjit Saverian të vitit 1881, në kohën kur Kraja ka qenë nxënës aty, na njoftohet se disa orë të caktuara mësimi zhvilloheshin në latinisht.

72 G. Pistulli, *Kolë Kraja: Autobiografi*, 62.

73 A.Q.Sh., F. 590, V. 1913, D. 54, fl. 5-5/1. Dokumenti i cituar është një letër që Kraja i dërgon së shoqes më 16 dhjetor 1913 nga “Grand Hotel Bellevue” ku po qëndronte. Që në rreshtat e parë të letrës dallojmë qartazi mahninë e mësuesit Kraja me Berlinin: «Berlin, 16 dhjetor 1913, E Dashtuna grue, Tesh dy ditë gjindemi n’Berlin, kenka gnji sceher i madh fort, t’gjith Schodra e jon nuk ban as gni ner disa mahall të këtie qytet. Scpijat nuk m’kan ciudit fort se cam paa edhe ner tjera vende, por m’caa ciudit drita e t’livritunit e nierzve ne mrame. T’duhet me diit qi rrugat scnrisin si ditën asctu edhe n’mbrâme bile mâa mir naten se ditën kur s’kâa diill». Letra mbyllet me porosinë që Kola i lë së shoqes për t’i përshëndetur fëmijët e tij.

74 G. Pistulli, *Kolë Kraja: Autobiografi*, 62-63.

75 Stanela Kostollari, Princ Vidi në fondet e Bibliotekës Kombëtare, 22 maj 2014, <https://www.youtube.com/watch?v=MgSbXUFq24w>

76 A. Krasniqi, *Sistemet Politike në Shqipëri: 1912-2008*, Shtëpia Botuese “UFO” Press, Tiranë, 2009, 48.

qeveritar të princ Vedit, të kryesuar prej Turhan Pashë Përmetit, ishte emërimi i mësuesit të parë të gjuhës shqipe të Vedit, Kolë Kraja, si dragoman (përkthyes) mbretëror.⁷⁷ Në oborrin mbretëror vuri jo pak lidhje të reja me klasën e re sunduese dhe jo vetëm. Për shembull ai u njoh me aristokraten bavareze, baroneshën Maria Emili Godin (1882-1956). Baronesha Godin ishte një njohëse e kulturës shqiptare dhe gjatë periudhës së mbretërimit të princ Vedit shërbeu si përkthyes në oborrin e tij. Pikërisht në këtë ambient të përbashkët ajo u njoh me Kolë Krajën, me të cilin pati një trajektore të gjatë bashkëpunimi në fushën e gjuhësisë shqiptare në veçanti.⁷⁸

Vargu i ngjarjeve dramatike përgjatë gjashtë muajve të mbretërimit jetëshkurtër e të palavdishëm të princ Vedit, e bënë atë të largohej nga Shqipëria, me shpresën se do të kthehej pas një fitoreje të Fuqive Qendrore në Luftën e Parë Botërore. Ai kthehet në atdheun e tij gjerman me gjithë familjen,⁷⁹ dhe bashkë me të shkon edhe Kolë Kraja i cili vendos t'i shërbejë mbretit - sikurse e quante ai princ Vedin në kujtimet e veta - në mërgim. Nga të dhëna të ndryshme na thuhet se Kolë Kraja qëndroi përgjatë gjithë viteve të Luftës së Parë Botërore, deri më 1920-n, me familjen e Vedit.⁸⁰ Burime të tjera thonë se Kolë Kraja u kthye për një copë kohë gjatë luftës në vendlindje, për të shërbyer në Bashkinë Shkodër, gjatë periudhës kur qyteti ishte nën pushtimin e forcave austro-hungareze dhe vëllai i tij Filipi, bënte pjesë në komisionin e komunitetit katolik në Shkodër të zgjedhur në majin e 1915-s.⁸¹

Pavarësisht këtyre mospërputhjeve faktike, kur lexojmë burimet dokumentare të prodhuara nga vetë dragomani mbretëror në detyrë - është fjala për një ditar që ai ka shkruar gjatë qëndrimit të tij pranë familjes princërore në Gjermani - mësojmë jo vetëm për jetën e pazakontë të një shkodrani shumë të kulturuar brenda gjirit të aristokracisë së lartë të Perandorisë Gjermane, por deduktojmë tërthorazi se Vilhelm Vidi krahas vizionit ëndërrimtar të rikthimit në fronin e Shqipërisë, edhe fantazonte me idenë megalomane që duke u mësuar shqipen fëmijëve të vet, do të

77 A.Q.Sh., F. 590, V. 1914, D. 27, fl. 1. Po citoj të plotë dokumentin e vendimit qeveritar të emërimit të Kolë Krajës si përkthyesi mbretëror i pallatit. «Zotni. Pas vendimit kabinetit i vertetur prej Lart Madhris Ti me 19 te marsit u emrove dragoman i pallatit Mbretit me pesqint (500) franga në muaj. Jani ftuar të mirni qe sot e tutje punen qe ju esht dhen.» Firmosur nga «Kryeministri edhe ministri i puneravet te perjashtme; Turhan Pasha. Me 25 te marsit 1914». I dërgohet Kolë Krajës.

78 R. Elsie, *A Biographical Dictionary of Albanian History*, 175.

79 A. Krasniqi, *Sistemet Politike në Shqipëri: 1912-2008*, 58-60.

80 A.Q.Sh., F. 590, Pa Vit, D. 17, fl. 21. Shih materialin jetëshkrimor për Kolë Krajën nga Gjon Kamsi.

81 N. Haxhia, *Një vështrim i shkurtër mbi veprimtarinë atdhetare të vëllezërve Filip dhe Kolë Kraja*, 150; Sh. Gurakuqi, *Ditare: 1914-1916, 1920*, përgatiti dhe pajisi me shënime Willy Kamsi, Shtëpia Botuese "Berk", Tiranë, 2022, 63. Në këtë komision bënte pjesë edhe Luigj Gurakuqi.

lidhte së tepërmi kulturalisht edhe shpirtërisht pinjollët e dinastisë së tij me popullin e vogël ballkanas. Sepse vetëkuptohet që Kraja vazhdonte të ishte tutor i fëmijëve të Vidit, Marie Eleonorës dhe Karl Viktorit, të cilët duhej ta dinin mirë gjuhën amtare të shtetasve të tyre.⁸²

Gjatë Luftës së Parë Botërore, Kolë Kraja vendohet në Valdenburg, rezidenca stërgjyshore e familjes së princ Vidit.⁸³ Kjo periudhë nuk do të ishte për të vetëm një kohë mësimdhënieje për fëmijët e princit në mërgim. Nisur nga ditari i vogël që na ka lënë për vitet e tij të qëndrimit në Rajhun II, mësojmë se koha e tij në dheun gjerman shënjohej nga eksplorimi i peizazheve magjepsëse të Saksonisë. Turizmi kulturor që po kështu në fokus të tij. Për shembull në Drezden, në dhjetor të 1914-s, ai vizitoi i mahnitur galerinë e artit dhe Teatrin e Operas ku ndoqi veprën e pavdekshme wagnerane "Lohengrin".⁸⁴

Për shkak të lidhjeve të ngushta me princ Vidin, Kolë Kraja pati avantazhin unik që të frekuentonte qarqet aristokratike të sërës së lartë gjermane. Ai rrallëherë merrte pjesë me përfaqësues të kësaj shtrese në sportin, «e zhurmshëm e të potershëm», - sipas fjalëve të tij - të gjuetisë, që aristokratët gjermanë kishin shekuj të tërë që e preferonin.⁸⁵

Dragomani Mbretinuer" nga gjithë vizitat e bëra anekënd Rajhut mbresën më të pashlyeshme ia lanë kështjellat e Shonsburgut dhe Rohsburgut, me bukuritë e tyre arkitekturore. Parapëlqimi i tij për këto dy objekte monumentale, të ndodhura majë kodrash, mund të jetë kushtëzuar nga reminishencat e tij për kështjellën e Rozafatit, e cila lartësohej mbi qytetin e tij të lindjes, Shkodrën; boshti ku vërtitej çdo mendim i tiji.⁸⁶

Pak para se të rikthehej në Shkodrën e tij të pazëvendësueshme, ai i dërgon një letër të birit për Pashkën e 1920-s ku i kushton edhe një poezi të shkurtër. Vargjet e poezisë vijojnë si më poshtë:

«Si dron gjarpnin rrenen druje,
Ndigio t'parët, pa ba kurr fjalë,
Banu trim e atdhen duje,
E duj msim e punë o djal».⁸⁷

Në këtë poezi të shkurtër Kraja vë theksin tek puna, edukata morale e atdhedashuria - tri shtyllat që sendërtonin qasjen e tij qoftë ndaj prindërimit, qoftë ndaj pedagogjisë. Përpjekjet e Krajës për të rrënjosur tek fëmijët e tij

82 R. Elsie, *A Biographical Dictionary of Albanian History*, 484.

83 D. Heaton-Armstrong, *The Six Month Kingdom: Albania 1914*, I.B. Tauris & Co. Ltd., New York, 2005, 175.

84 A.Q.Sh., F. 590, V. 1914, D. 3, fl. 5.

85 *Ibid.*, fl. 27.

86 *Ibid.*, fl. 13/1.

87 A.Q.Sh., F. 590, V. 1920, D. 4, fl. 1.

këto vlera janë një pasqyrë e qartë e sistemit pedagogjik ku mbështetej.

Kur dragomanit mbretëror dhe mësuesit të shqipes nga Shkodra po i afrohej koha të largohej edhe të kthehej në Shqipëri, Vidi më 1919 i jep atij një medalje në shenjë vlerësimi për besnikërinë edhe shërbimet e veta pranë familjes së parë mbretërore të Shqipërisë Pavarur.⁸⁸

5. Apogjeu i Kolë Krajës, 1920-1948

Pas mbarimit të Luftës së Parë Botërore, Shqipëria, megjithëse nuk kishte qenë pjesëmarrëse në konflikt, u gjend nën pushtimin e forcave ushtarake fituese të Antantës. Mirëpo, me kthimin e Kolë Krajës më 1920, Shqipëria kishte arritur të rikonfirmonte pavarësinë e saj si entitet ndërkombëtar përmes vendimeve të Kongresit të Lushnjes që u mbledh kryesisht si pasojë e qëndrimeve jo të drejta që mbajtën më 1919 Fuqitë e Mëdha për kufijtë shqiptarë në Konferencën e Paqes në Paris dhe fitores ushtarake të popullit shqiptar në Luftën e Vlorës.⁸⁹

Kjo periudhë rimëkëmbjeje për Shqipërinë në rrafshin ekonomiko-shoqëror dhe për sa i përket shtimit të përpjekjeve për të zgjeruar klimën pluraliste në politikën shqiptare veçohet për një zhvillim të vrullshëm kulturor. Një prej formave më të përhapura të manifestimit të këtij zhvillimi qe themelimi i grupeve a shoqërive të ndryshme kulturore me ide edhe pikëpamje të forta për demokratizimin e oksidentalizimin e vendit.⁹⁰

Kolë Kraja do të ishte një nga bashkëthemeluesit e një prej këtyre shoqërive kulturore, të Shoqnisë “Vllaznija” që u ngrit në Shkodër më 16 shkurt 1919.⁹¹ Mes themeluesve të tjerë shquhen emra me peshë në jetën social-kulturale shkodrane e më gjerë si Kel Marubi, Shuk Gurakuqi, Ali Borshi etj. Kjo shoqëri, e paorientuar politikisht, u ngrit nga djalëria e krishterë dhe myslimane e Shkodrës dhe i blatoi metropolit verior shqiptar aq shumë kontribute në disa sfera (për shembull themeloi klubin e parë futbollistik në vend, skuadrën “Vllaznija”). Edhe pse e themeluar në Shkodër, shoqëria në fjalë, e përbërë nga të rinj me ndjenja të pjekura atdhedashurie kërkonte që veprimtaria e saj të shtrihej në të gjithë vendin. Kjo nuk reflektohet kurrkund tjetër më mirë sesa në programin e vet, ku në pikën e parë shkruhej: «Të zgjuemit e djelmnis shqyptare në fushë letrare, teatrale, muzikale e gjimnastikale, pa u përzie në çashtjet politike».⁹² Duke pasur parasysh, objektivat e saj tejet

88 N. Haxhia, *Një vështrim i shkurtë mbi veprimtarinë atdhetare të vëllezërve Filip dhe Kolë Kraja*, 150. Në certifikatën e medaljes që Vidi i dha Kolë Krajës shkruhet: “Unë Vilhelm Vid jap në shenjë nderimi medaljen për punë të palodhur, të ndershme e të kujdesshme Nikolaus Kraja gjatë qëndrimit në Valdenburg.”

89 T. Zavalani, *Histori e Shqipnis*, Phoenix, Tiranë, 1998, 258-261.

90 *Grup autorësh, Historia e Popullit Shqiptar III...*, 374-375.

91 A.Q.Sh., F. 447, Pa vit, D. 163, fl. 3.

92 *Ibid.*, fl. 3/1.

ambiciozë, shoqëria “Vllaznia” u organizua mjaft mirë për të përmbushur sa më me efikasitet programin e saj shumëplanësh. Shumë shpejt hapen degët muzikore, teatrale, letrare e të gjimnastikës ku punonin talentet e reja të Shkodrës sipas degëve përkatëse.⁹³

Kolë Kraja do të zgjidhej kryetar i kësaj shoqërie më 16 tetor 1921 nga paria drejtuese e shoqërisë.⁹⁴ Në një fjalim të zjarrrtë që mban në kuadër të zgjedhjes së vet si drejtuesi i “Vllaznisë”, ai shpreh hapur motivin që e nxiti të merrte përsipër këtë detyrë: «I shtyem prej ndiesis të detyreve qi kam ndaj të dashtunit qytetit tem fillova me u përkulë».⁹⁵ Ai do ta mbante këtë post për dy vite.⁹⁶

Po kështu, Kraja me kthimin e tij në atdhe do të rifillonte në qershor të 1921-shit karrierën e ndërprerë të mësuesit po në qytetin e tij të lindjes, ku zë të punojë si mësues frëngjishteje në dy shkolla mashkullore qytetase.⁹⁷ Reputacioni i tij si një mësues i shkëlqyer i frëngjishtes bëri që Kraja një vit më vonë të emërohej mësues me kohë të plotë i gjuhës frënge në Gjimnazin e Shtetit në Shkodër, menjëherë sapo ky institucion çeli dyert.⁹⁸

Duke pasur parasysh se sistemi shkollor shqiptar asokohe që huazuar nga ai francez dhe zviceran, me vendim të Kongresit Arsimor më 1922, lënda e Kolë Krajës ishte më e rëndësishmja brenda kornizës kurrikulare të vetë gjimnazit.⁹⁹

Viti 1922 nuk e gjeti të angazhuar vetëm si mësues, apo si pjesëmarrës tejet energjik në jetën kulturore të qytetit ku drejtonte “Vllazninë”, por edhe në një aktivitet tjetër ku do të gërshetoheshin të dyja këto fusha. Kjo kishte të bënte me përfshirjen e tij në Lidhjen e mësuesve të Prefekturës së Shkodrës. E themeluar në qershor të 1922-shit, kjo lidhje, ashtu si shumë të tjera në prefekturat kryesore të Shqipërisë së viteve 1920’, që rrjedhojë e përpjekjeve për demokratizimin e jetës politike të vendit mbështetur në frymën liberale perëndimore. Programi i kësaj lidhjeje përmbante kërkesa të drejta e të domosdoshme për kohën që kishin të bënin me arsimin, dhe në një shkallë më të vogël me kulturën qytetare.¹⁰⁰

93 A.Q.Sh., F. 590, Pa vit, D. 6, fl. 1/1-2/1.

94 A.Q.Sh., F. 447, Pa vit, D. 163, fl. 64-65/1.

95 A.Q.Sh., F. 590, Pa vit, D. 6, fl. 4.

96 N. Haxhia, *Një vështrim i shkurtë mbi veprimtarinë atdhetare të vëllezërve Filip dhe Kolë Kraja*, 150.

97 A.Q.Sh., F. 590, V. 1921, D. 27, fl. 2.

98 A.Q.Sh., F. 369, V. 1922, D. 1, fl. 1.

99 Instituti i Studimeve Pedagogjike (Ministria e Arsimit dhe e Shkencës), *Historia e Arsimit dhe e Mendimit Pedagogjik Shqiptar*, Vëllimi I, Shtypshkronja “Nënë Tereza”, Tiranë, 2003, 389.

100 Xh. Repishti, *Lëvizja sindikale e mësuesve shqiptarë në vitet 1921-1924*, Drejtorja Qendrore e Poligrafisë, Tiranë, 1974, 21-22.

Në një mbledhje të lidhjes ai artikuloi idenë e hapjes së një muzeu historik në Shkodër dhe bëri thirrje për emancipimin e gruas.¹⁰¹

Ndërkohë me pedagogjinë e tij dhe përkujdesin që shfaqti me nxënësit e vet fitoi respektin edhe dashurinë e tyre. Një ilustrim i këtij pohimi dokumentohet tek kujtimet e antropologut të parë shqiptar me prejardhje nga Fieri, Jakov Milaj, në kohën kur ishte nxënës në Gjimnazin e Shtetit. Në këto kujtime shkruhet për mësuesin, në atëkohë plak, Kolë Kraja: «Me Kolë Krajën lidha miqësi (atë miqësi që mund të lidhë nxënësi i ri me mësuesin e moçëm) që në fillim të vitit shkollor 1926-27. Ai nuk ma mbajti mend emrin asnjëherë dhe prandaj më thërriste gjithmonë “toska i vogël”, pse midis tre jugorëve që gjendeshin në klasën e tretë, unë isha më i imti».¹⁰²

Në fund të viteve 1920', Kolë Kraja u mor me studime në fushën e gjuhësisë e të historisë. Ai i përdori ato më së shumti me rastin e bashkëpunimit me miken e tij të kahershme Amelie fon Godinin për botimin e fjalorit gjermanisht-shqip (një gjë e tillë vihet në dukje në parathënien e kësaj vepre). Gjatë kësaj kohe, në lëmin e historisë bëri orvatje për të përshtatur në shqip një monografi mbi Skënderbeun, duke u mbështetur në shkrimtarë dhe historianë shqiptarë e të huaj.¹⁰³

Sipas të dhënave historike dimë se mësuesi Kolë Kraja vazhdoi të ishte pjesë e stafit mësuesor të Gjimnazit të Shtetit gjer më 1935, në moshën 70-vjeçare. Lind natyrshëm mendimi se pastaj doli në pension.¹⁰⁴

Dy vite më vonë, në kohën kur vendi kremtonte 25-vjetorin e Pavarësisë, qeveria shqiptare ngriti një komision jo vetëm për të organizuar festimet e këtij jubilar, por edhe për të vlerësuar figurat e shquara që kishin kontribuar në mëvetësinë e Shqipërisë. Struktura në fjalë mori emërtesën Komisioni i 25-Vjetorit të Vetëqeverimit. Ja që emri i Kolë Krajës nuk mund të mos mungonte në diskutimet e njërës prej grupeve të punës së këtij komisioni kaq të rëndësishëm shtetëror.¹⁰⁵

Kolë Kraja, i cili për thuajse 65 vite u njoh si një veprimtar i palodhur atdhedashës dhe vigan i përndritur në historinë e pedagogjisë shqiptare, duke i shërbyer gjuhës shqipe në fazat më kritike të lëvritit të saj në rrafshin arsimor si një rilindas i vërtetë, kaloi në amshim në Shkodër më 9 maj 1948.¹⁰⁶

101 A.Q.Sh., F. 590, Pa Vit, D. 17, fl. 19-19/1.

102 J. Milaj, *Kujtime për Shkodrën e viteve 1926-1931*, Botimet “Shkodra”, Shkodër, 2023, 31-32.

103 Z. Dibra, *Fjalor Enciklopedik i Hapësirës Shkodrane: A-K*, Vëllimi I, 730-731.

104 Z. Lungu, *Gjimnazi i Shtetit Shkodër (Drejtuesit, mësuesit, nxënësit)*, Shtëpia Botuese “Vllamasi”, Tiranë, 2015, 56.

105 A.Q.Sh., F. 170, V. 1937, D. 2, fl. 94

106 S. Pepa, *Punoi për shkollën dhe gjuhën shqipe*, 3.

Përfundime

Si përfundim, bazuar në analizën e mësipërme që iu bë dokumenteve parësore dhe burimeve dytësore, del qartë se Kolë Kraja shfaqet si një veprimtar atdhetdashës tejet i përkushtuar për çështjen kombëtare shqiptare dhe një mësimdhënës i zellshëm që u rrek të çonte para përparimin e gjuhës edhe kulturës shqipe. Me mjetet e veta pedagogjike dhe vetëmohimin për të sendërtuar me aq forcë sa kishte platformën e Rilindjes Kombëtare, ai edukoi atdhetarizmin shqiptar ndër radhët e nxënësve të vet dhe luftoi didaktikisht për të mbrojtur kombin e tij nga asimilimi. Me prejardhje nga një prej vatrave më të ndezura të Rilindjes Kombëtare Shqiptare siç ishte Shkodra, por edhe edukata familjare e Kolë Krajës, ndërthurur me trajektoren e formimit të tij intelektual në Kolegjin e “Shën Françesk Saverit”, frymëzuan dhe rrënjosën tek ai një dashuri të pamatë për dijen e atdheun, të cilat shërbyen si forcat kryesore shtytëse të veprimtarisë së tij të gjatë jetësore në shërbim të kulturës edhe arsimit shqiptar.

Duke nisur karrierën si arsimtar i ri, qëndrimi i Krajës në shkollat vllehe e pajisi atë me aftësi kompetente pedagogjike, gjë e cila i mundësoi atij të përmbushte disa objektiva vendimtarë të axhendës së Rilindjes Kombëtare Shqiptare – lëvrimi, propagandimi i gjuhës shqipe dhe edukimi përmes saj, pavarësisht pengesave nga Perandoria Osmane. Përkushtimi i palodhur i Krajës për këtë kauzë la gjurmë të pashlyeshme dhe e veçoi atë si një patriot të dalluar në tre nga katër vilajetet shqiptare. Veprimtaritë e tij klandestine pedagogjike edhe kulturore në Manastir hodhën themelet për përpjekjet e tij të mëvonshme në shërbim të shqipes, pavarësisht se u përball me mbikëqyrje dhe ndëshkim të rreptë nga autoritetet osmane.

Në Berat, ortakëria e Kolë Krajës me bashkëpatriotin Babë Dudë Karbunara fuqizoi më tej përkushtimin e tij ndaj shkollës shqipe, duke i dhënë mësuesit shkodran njohjen si një patriot vërtetë të mbrujtur me idealet e Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Gjithashtu, Kolë Kraja gjatë qëndrimit në qytetin e Gjirokastrës, në vilajetin e Janinës, angazhohet në mënyrë aktive në përhapjen e kulturës shqiptare, gjithmonë në kushtet e një fshehtësie tepër të madhe. Këtu, aktivitetet e tij u shtrinë përtej mësimave klandestine të shqipes, duke përfshirë edhe shpërndarjen e fshehtë të revistave patriotike të Rilindjes si “Drita”. Veprime të tilla i hapën probleme të herëpashershme mësuesit të censhëm shkodran për thuajse 30 vite me radhë (1883-1912).

Gjatë gjithë përpjekjeve të tij për çështjen kombëtare, Kolë Kraja lidhi miqësi dhe bashkëpunoi me figura të shquara të Rilindjes Kombëtare, veçanërisht me Pashko Vasën dhe Filip Shirokën. Vepra e paepur e mësuesit Kraja në dobi të kulturës dhe gjuhës shqipe u njoh edhe nga shteti i ri i sapokrijuar i Shqipërisë më 1912. I emëruar fillimisht si dragoman mbretëror i princ Vidit, Kraja mandej u emërua si mësues i gjuhës frënge

në gjimnazin e parë publik laik në vend në vitin 1922.

Për sa i përket angazhimeve të frytshme kulturore të Kolë Krajës, ato arritën zenitin në qytetin e Shkodrës, në kohën kur luante rol aktiv në shoqëritë kulturore si “Gjuha Shqype” dhe “Vllaznija”.

Puna përparimtare pedagogjike, didaktika shembullore dhe ndihma e pareshtur që dha Kolë Kraja në çështjet e kulturës e të arsimit shqiptar para edhe pas Pavarësisë së vendit e bëjnë figurën e tij të ketë formatin e mirëfilltë të një rilindasi të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, që luftoi pa rezerva për zhvillimin e shkollës shqipe.

BIBLIOGRAFI

I. Dokumente arkivore:

1. A.M.H.Sh., Fondi: Arkivi i Vjenës, 1908-1911, fl. 502-503.
2. A.Q.Sh., F. 2 (Aleksandër Stavri Drenova),¹⁰⁷ Pa vit, D. 74/1, fl. 262.
3. A.Q.Sh., F. 17 (Gjergj Fishta), V. 1916-1937, D. 94, fl. 17.
4. A.Q.Sh., F. 20 (Ismail Qemali), V. 1910, D. 5, fl. 1.
5. A.Q.Sh., F. 132 (Arqipeshkvia e Shkodrës), V. 1881, D. 20, fl. 47/1-48, 49.
6. A.Q.Sh., F. 170 (Komisioni i 25-Vjetorit të Vetëqeverimit), V. 1937, D. 2, fl. 94.
7. A.Q.Sh., F. 369 (Drejtorja e Gjimnazit Shtetëror), V. 1922, D. 1, fl. 1.
8. A.Q.Sh., F. 447 (Koleksion i Partive, Organizatave dhe Shoqërive), Pa vit, D. 163, fl. 3, 3/1, 64-65/1,
9. A.Q.Sh., F. 580 (Kel Marubi), V. 1912, D. 29, fl. 1.
10. A.Q.Sh., F. 590 (Nikollë Kraja), Pa vit, D. 1, fl. 1.
11. A.Q.Sh., F. 590, Pa vit, D. 6, fl. 1/1-2/1, 4.
12. A.Q.Sh., F. 590, Pa vit, D. 17, fl. 1, 9, 17, 18, 19-19/1, 21.
13. A.Q.Sh., F. 590, V. 1913, D. 54, fl. 5-5/1.
14. A.Q.Sh., F. 590, V. 1914, D. 3, fl. 5, 13/1, 27.
15. A.Q.Sh., F. 590, V. 1914, D. 27, fl. 1.
16. A.Q.Sh., F. 590, V. 1920, D. 4, fl. 1.
17. A.Q.Sh., F. 590, V. 1921, D. 26, fl. 1.
18. A.Q.Sh., F. 590, V. 1921, D. 27, fl. 2.
19. A.Q.Sh., F. 590, V. 1929, D. 2, fl.1-2, 3.
20. A.Q.Sh., F. 590, V. 1929, D. 57, fl. 5.
21. A.Q.Sh., F. 590, V. 1933, D. 56, fl. 1-1/1.

II. Monografi shkencore:

1. Grup autorësh, *Historia e Popullit Shqiptar II: Rilindja Kombëtare, vitet 30' të shek. XIX-1912*, Botimet “Toena”, Tiranë, 2002, 247, 253.

107 Në kllapa janë vendosur emrat e fondeve të Arkivit Qendror të Shtetit të Republikës së Shqipërisë.

2. Grup autorësh, *Historia e Popullit Shqiptar III: Periudha e Pavarësisë, 28 Nëntor 1912 – 7 Prill 1939*, Botimet "Toena", Tiranë, 2007, 46-47, 49, 57, 374-375.
3. Instituti i Studimeve Pedagogjike (Ministria e Arsimit dhe e Shkencës), *Historia e Arsimit dhe e Mendimit Pedagogjik Shqiptar*, Vëllimi I, Shtypshkronja "Nënë Tereza", Tiranë, 2003, 389.
4. *Knime t'para për t'rritshëm*, Shtypshkronja "Nikaj", Shkodër, 1911, 3-35.
5. *Kolegja Saverjane: Nder 50 vjetët e para*, Shtypshkronja "Zoja e Papërlyeme", Shkodër, 1928, 9, 7, 11, 13, 27, 79.
6. *Programi i Shkollve Tregtare në Kolegj të Shë Françesk Saverit*, Shtypshkronja e "Zojës së Papërlyeme", Shkodër, 1921, 1-14.
7. Afrim Krasniqi, *Sistemet Politike në Shqipëri: 1912-2008*, Shtëpia Botuese "UFO" Press, Tiranë, 2009, 48, 58-60.
8. Duncan Heaton-Armstrong, *The Six Month Kingdom: Albania 1914*, TJ International Ltd, New York, 2005, 175.
9. Edwin E. Jacques, *Shqiptarët: Historia e popullit shqiptar*, përkthyer nga Edi Seferi, Vëllimi I, Yeni Yasam Yayinlari Ltd, Stamboll, 1995, 385-386.
10. Eqrem bej Vlora, *Kujtime: 1885-1925*, përkthyer nga Afrim Koçi, Botimet "IDK", Tiranë, 2001, 612.
11. Hamdi Bushati, *Shkodra dhe Motet*, Vëllimi I, Shtëpia Botuese "Idromeno", Shkodër, 2005, 439, 440.
12. Hysni Myzyri, *Shkollat e Para Kombëtare Shqipe (1887-korrik 1908)*, Shtëpia Botuese "8 Nëntori", Tiranë, 1978, 46.
13. Ines Murzaku, *Historia e Jezuitëve në Shqipëri (1841-1946): Katolicizmi, Kultura dhe Kthimi në besim*, Qendra Botuese "Shoqata e Jezuitëve", Tiranë, 2022, 64, 70.
14. Jakov Milaj, *Kujtime për Shkodrën e viteve 1926-1931*, Botimet "Shkodra", Shkodër, 2023, 31-32.
15. Lucia Nadin, *Shqiptarët në Venedik: Mërgim e integrim, 1479-1552*, përkthyer nga Pëllumb Xhufi, Shtëpia Botuese "55", Tiranë, 2008, 85.
16. Ludovik Shllaku, *Shkollat Klerikale: Vështrim historik nga fillimet deri më 1924*, Shtëpia Botuese "Camaj-Pipa", Shkodër, 2002, 162.
17. Markus W. E. Peters, *Shtëpia botuese më e vjetër e Shqipërisë dhe kontributi i saj për Lëvizjen Kombëtare, arsimimin dhe kulturën: "Tipografia e Zojës së Papërlyeme" në Shkodër (1870-1945)*, Qendra Botuese Shoqata e Jezuitëve, Tiranë, 2016, 56.
18. Nertila Haxhia, *Një vështrim i shkurtë mbi veprimtarinë atdhetare të vëllezërve Filip dhe Kolë Kraja*, në P. Perja (ed.) *Seminari i Tretë Ndërkombëtar "Shkodra në Shekuj": Vëllimi I*, (seksioni i historisë dhe arkeologjisë), Shkodër, 2000, 149, 150, 151.
19. Njazi Kazazi, *Zhvillimi i Arsimit të Mesëm në Shkodër: nga fillimet e tij deri në vitet '20 të shek. XX*, Shtëpia Botuese "Rozafa", Shkodër, 2014, 42, 44-45.
20. Robert Elsie, *A Biographical Dictionary of Albanian History*, I.B. Tauris

- & Co. Ltd, New York, 2013, 138-139, 175, 484.
21. Romeo Gurakuqi, *Shqipëria: 1911-1914*, UET Press, Tiranë 2012, 521.
 22. Shuk Gurakuqi, *Ditare: 1914-1916, 1920*, përgatiti dhe pajisi me shënime Willy Kamsi, Shtëpia Botuese "Berk", Tiranë, 2022, 63.
 23. Tajar Zavalani, *Histori e Shqipnis*, Phoenix, Tiranë, 1998, 258-261.
 24. Tomor Osmani, *Udhë e Shkronjave: Histori e Alfabetit*, Shtypshkronja "Ilar", Tiranë, 2008, 506, 511, 542.
 25. Xhevat Repishti, *Lëvizja sindikale e mësuesve shqiptarë në vitet 1921-1924*, Drejtoria Qendrore e Poligrafisë, Tiranë, 1974, 21-22.
 26. Zenepe Dibra, *Fjalor Enciklopedik i Hapësirës Shkodrane: A-K*, Vëllimi I, Enti Botues "Gjergj Fishta", Lezhë, 2015, 39-40, 730-731.
 27. Zija Shkodra, *Esnafet Shqiptare: shek. XV-XIX*, Shtypshkronja "Mihal Duri", Tiranë, 1973, 327.
 28. Zyhdi Lungu, *Gjimnazi i Shtetit Shkodër (Drejtuesit, mësuesit, nxënësit)*, Shtëpia Botuese "Vllamasi", Tiranë, 2015, 56.

III. Artikuj shkencorë:

1. *Extract from Ignatian Pedagogy: A Practical Approach (1993)*, "International Studies in Catholic Education" V (2013), 1, 5.
2. F. B. K. (pseudonim i Faik Konicës), *Kleri i huaj edhe Jesuitet ne Shqypeni, "Albania" IV (1900)*, 3, 77-78.
3. Giuseppe Motta, *The Fight for Balkan Latinity. The Aromanians until World War I*, "Mediterranean Journal of Social Science" II (2011), 3, 254.
4. Guljelm Pistulli, *Kolë Kraja: Autobiografi*, "Phoenix" IX (2005), 1-6, 57, 58, 59, 61, 62-63.
5. Simon Pepa, *Luftëtar e atdhetar i vendosur*, "Jeta e Re" XX (12.03.1986), 21, 3.
6. Simon Pepa, *Punoi për shkollën dhe gjuhën shqipe*, "Jeta e Re" XV (03.10.1981), 79, 3.
7. Zija Shkodra, *Problemi i tregut shqiptar në shek. XVIII*, "Studime Historike" XX (1966), 3, 68-69.

IV. Burime nga interneti:

1. Stanela Kostollari, Princ Vidi në fondet e Bibliotekës Kombëtare, 22 maj 2014, <https://www.youtube.com/watch?v=MgSbXUFq24w>

